



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TË DREJTËS PËR INFORMIM DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 2216/2 Prot.

Tiranë, më 08/11/2024

VENDIM

Nr. 27, datë 08.11.2024

PËR

ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shkronja i) e pikës 1 të nenit 7, nenit 8, nenit 9, pikës 1 dhe shkronjat c) dhe dh) të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me pikën 1, të nenit 9/1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, (në vijim “LDI”) ku përcaktohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (“Komisioneri”) është autoriteti i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji”, si dhe mbështetur në shkronjën c), të pikës 2, të nenit 9/1 të LDI, si dhe në zbatim të detyrave të lëna nga rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Vitin 2023”, si dhe planin vjetor të punës, ka kryer monitorimin e publikimit/përditësimit të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, në faqen zyrtare të Autoritetit Publik Bashkia Pukë.

Sipas shkronjës b) të pikës 2 të nenit 10 të LDI, Koordinatorin për të drejtën e informimit krijon, mban, publikon dhe përditëson Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 8 të këtij ligji.

Në pikën 1 të nenit 8 të LDI parashikohet: “..... Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk

pasqyrohet në regjistër”.

Pika 2 e nenit 8 të LDI parashikon se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit”.*

Në zbatim të pikës 2 të nenit 8 të LDI, Komisioneri ka miratuar formatin dhe përmbajtjen e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve me Urdhërin nr. 188/2020 *“Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”*, i ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin e faqes zyrtare të Autoritetit Publik Bashkia Pukë <https://bashkiapuke.gov.al>, në përfundim të së cilit ka rezultuar se nuk është përmbushur detyrimi ligjor i përcaktuar në nenin 8, të LDI, për të publikuar Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Pukë, sipas kërkesave të ligjit dhe sipas formatit dhe përmbajtjes së Urdhërit nr. 188/2020 *“Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”* i ndryshuar.

Referuar konstatimeve të mësipërme, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë Autoritetit Publik shkresën nr. 2216 prot., datë 14.10.2024, *“Njoftim për konstatimin e kundravajtjes dhe fillimin e procedurës së shqyrtimit të saj”*, nëpërmjet të cilës, njoftoi konstatimin e mospublikimit të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Referuar pikës 2 të nenit 10, si dhe të pikës 3 të nenit 19 të LDI përgjegjësia për krijimin, mbajtjen, publikimin dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar, rezulton e Koordinatorit për të Drejtën për Informim të Autoritetit Publik, z. S. Gj..

Në këto kushte, me qëllim ushtrimin e të drejtës për tu dëgjuar, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, nëpërmjet shkresës nr. 2216 prot., datë 14.10.2024, drejtuar z. S. Gj., duke vënë në dijeni edhe titullarin e autoritetit publik, Komisioneri njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 22.10.2024, por z. S. Gj. njoftoi me anë të email-it se nuk mund të paraqitej dhe kërkoi shtyrje të seancës dëgjimore me datë 25.10.2024, ora 11.00. Zyra e Komisionerit pranoi kërkesën e z. S. Gj. dhe e njoftoi atë për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 25.10.2024.

Seanca dëgjimore, sipas lajmërimit me email dhe sipas konfirmimit të pjesëmarrjes së z. S. Gj. me e-mailin e datës 22.10.24, u zhvillua më datë 25.10.2024, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Në këtë seancë u paraqit z. S. Gj., Koordinator i së Drejtës për Informim pranë Autoritetit Publik Bashkia Pukë, i cili parashitri se *“kryen këtë detyrë përveç pozicionit parësor si Drejtor i Menaxhimeve të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Pukë. Gjatë 14 muajve që kam mbajtur këtë detyrë autoriteti ka patur kërkesa dhe ne i kemi kthyer përgjigje dhe i mbajmë të regjistruara në regjistrin tonë fizik. Marrë përsipër që rregjistrin fizik të kërkesave dhe përgjigjeve t’ua dërgoj si provë e çka parashitroj brenda ditës së hënë”.*

Gjatë mbajtjes së seancës u krye verifikim online, dokumentuar nëpërmjet *videoscreen*, ku rezultoi se në faqen zyrtare nuk ishte i aksesueshëm regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, fakt i cili iu vu në dukje dhe u pranua nga z. S. Gj. gjatë seancës. Nëpërmjet komunikimit

elektronik z. S. Gj. dërgoi me datë 28.10.2024 në adresën elektronike të Zyrës së Komisionerit, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, por ky i fundit nuk është i plotësuar sipas formatit dhe përmbajtjes të miratuar me Urdhër nga Komisioneri.

Po ashtu, deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, rezulton se Koordinatori i së Drejtës për Informim vijon të jetë në mospërmbushje të detyrimit ligjor, pasi nuk ka bërë publikimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve sipas kërkesave të LDI dhe formatit dhe përmbajtjes të Urdhrit nr. 188/2020 të Komisionerit.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të pasur akses në dokumentet zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve përfaqëson një ndër instrumentet kryesore të promovimit të transparencës së autoriteteve publike dhe garantimit të së drejtës për informim të publikut.

Nga monitorimi i kryer nga Zyra e Komisionerit dhe shqyrtimi administrativ më pas, rezultoi se Koordinatori për të Drejtën për Informim pranë Autoritetit Publik Bashkia Pukë, z. S. Gj., nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor, si dhe argumentet apo provat e paraqitura janë të pamjaftueshme për të arsyetuar mospërmbushjen dhe mosrespektimin e dispozitave të LDI dhe Urdhërit nr. 188/2020 të Komisionerit.

Pika 1 e nenit 18 të LDI, parashikon se: *“Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”*.

Ndërsa në shkronjën d) të pikës 2 të nenit 18 të LDI parashikohet se: *“moskrijimi, mosmbajtja, mospublikimi apo mospërditësimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 100 000 lekë”*.

Në pikën 3 të nenit 19 të LDI, parashikohet se: *“Koordinatori për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “d” dhe “e” të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji”*.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet, që rezultuan nga monitorimi dhe shqyrtimi administrativ, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për të publikuar Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Pukë, sipas kërkesave të LDI dhe sipas formatit dhe përmbajtjes së Urdhërit nr. 188/2020 *“Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”*, mosveprim që konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me shkronjën d), të pikës 2 të nenit 18 të LDI.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën dh) të pikës 2 të nenit 9/1, të shkronjës d) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22 dhe 23 të ligjit 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”* të ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”* dhe shkronjën b) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin*

dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Koordinator për të drejtën për informim pranë Autoritetit Publik Bashkia Pukë, në përmbushje të detyrimeve të shkronjës b) të pikës 2 të nenit 10 dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 8 ligjit nr. 119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, të ndryshuar, të krijojë, mbajë, bëjë publik dhe përditësojë Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, sipas Urdhërit nr. 188/2020 “*Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar*”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 27.11.2024.
2. Dënimin e z. S. Gj., Koordinator për të Drejtën e Informimit të Autoritetit Publik Bashkia Pukë në kohën e konstatimit dhe shqyrtimit të kundravajtjes administrative, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.
3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Autoritetit Publik Bashkia Pukë, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikën 1, Autoriteti Publik ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*” të ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “*Për të drejtën e informimit*”, të ndryshuar.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “*Për të drejtën e informimit*” të ndryshuar, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*”.

Ky vendim u shpall sot në datë 08.11.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi